




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO



KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA - KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

**BULETINI I KËSHILLIT
PROKURORIAL TË
KOSOVËS 2024**



Prishtinë, 2024

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në këtë edicionin pasqyrohen aktivitetet e KPK-
së për muajin nëntor të vitit 2024)

Kryesuesi Hajdaraj priti në takim Ambasadorin Britanik, z. Jonathan Hargreaves

Prishtinë, 5 nëntor 2024 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z. Ardian Hajdaraj, ka pritur në takim Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, z. Jonathan Hargreaves dhe bashkëpunëtorët e tij.

Më këtë rast, Kryesuesi Hajdaraj bëri një falënderim të veçantë për institucionet britanike, të cilat i kanë dhënë mbështetje të vazhdueshme sistemit prokurorial gjatë proceseve të konsolidimit dhe zhvillimit të tyre, duke shprehur përkushtimin e tij për të zhvilluar partneritetin e mëtejshëm për avancimin dhe fuqizimin e rendit dhe sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.



Gjithashtu gjatë takimit të sotëm është diskutuar për ecurinë e zbatimit të Memorandumit të Bashkëpunimit të Këshillit Prokurorial me Qeverinë Britanike për hartimin e Rregullores për Themelimin e Ekipeve të Përbashkëta Multidisiplinare dhe për sfidat aktuale të sistemit prokurorial.

“Shpreh zotimin tonë se brenda këtij viti do të miratohet kjo rregullore e rëndësishme nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës”, tha më këtë rast kryesuesi Hajdaraj.

Ndër të tjera, z.Hargreaves, theksoi se misioni diplomatik i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë mirëpret dhe angazhohet për fuqizimin e sistemit prokurorial, kurse në këtë kontekst, të dy bashkëbiseduesit u pajtuan që iniciativat e përbashkëta të jetësohen sa më parë dhe të ketë fokusim të plotë në proceset e zbatimit të reformave në sistemin e drejtësisë, proces ky, i cili mbështet nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë.



Analizohet zbatimi i Planit strategjik 2022-2024 I Këshillit Prokurorial, Grantolli: Plani 2025-2027 ka në fokus rritjen e efikasitetit të përgjithshëm të sistemit prokurorial

Prishtinë, 5 nëntor 2024 - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), gjegjësisht, Grupi punues për hartimin e Planit strategjik dhe Planit të veprimit të sistemit prokurorial 2025-2027, ka mbajtur një takim për analizimin e zbatimit të Planit strategjik 2022-2024, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij grupi dhe përfaqësuesit e partnerëve ndërkombëtarë.

Kryesuesja e Grupit punues për hartimin e Planit strategjik, njëherësh Zëvendëskryesuesja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, znj. Jehona Grantolli, prezantoi analizën e zbatimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024, plan ky, që ishte korniza kryesore e planifikimit të politikave për menaxhimin e sistemit prokurorial në tri vjetët e kaluar. “Megjithatë, përkundrejt sfidave të shumta që na kanë përcjellë si sistem prokurorial ka të arritura të shumta, por në fokus të Planit 2025-2027 do të jetë rritja e efikasitetit të përgjithshëm të sistemit prokurorial”, tha znj. Grantolli.



Me këtë rast pati diskutime për çështje të ndryshme planifikuese, sidomos për ato që ndërlidhen me proceset e shtyllave kryesore, siç janë: profesionalizmi dhe pavarësia e sistemit prokurorial, efikasiteti dhe efektiviteti në ndjekjen e krimit, profilizimi i prokurorëve dhe trajtimi i rasteve penale, menaxhimi dhe administrimi, llogaridhënia, masat dhe veprimet specifike për promovimin e transparencës publike dhe çështjeve që ndërlidhen me integrimin evropian.



Ndërkaq, Kryesuesi i KPK-së, Ardian Hajdaraj, duke vlerësuar të arriturat, ka përmendur njëkohësisht edhe sfidat që janë paraqitur gjatë zbatimit të këtij plani, sidomos çështjet që kanë të bëjnë me mungesat buxhetore dhe ato që kanë të bëjnë me reformat në sektorin e drejtësisë.

Ky takim ka vazhduar me diskutime të përfaqësuesve të partnerëve ndërkombëtarë dhe pjesëmarrësve nga sistemi prokurorial, me ç'rast janë dhënë komente, rekomandime dhe sugjerime të ndryshme.



Ngritja e bashkëpunimit të ndërsjellë, temë e diskutimit ndërmjet Kryesuesit Hajdaraj dhe përfaqësuesve të Rrjetit të OJQ-ve AVONET

Prishtinë, 6 nëntor 2024 - Në kuadër të takimeve dhe diskutimeve që ndërlidhen me forcimin e sundimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të shoqërisë civile dhe mediave, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Ardian Hajdaraj, priti në takim përfaqësuesit e Rrjetit të Organizatave Joqeveritare, AVONET, të kryesuar nga Drejtori Ekzekutiv, Kenan Gashi.



Qëllimi i takimit ishte diskutimi i aspekteve të bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të sistemit prokurorial dhe Rrjetit të OJQ-ve - AVONET, me synimin që ai të jetë në të ardhmen më i afërt dhe thelbësor.

Më këtë rast, z.Ardian Hajdaraj u zotua se do të angazhohet me vullnet dhe përkushtim për ngritjen e bashkëpunimit sa më të afërt me shoqërinë civile, përkatësisht me AVONET-in, si dhe do të ketë bashkëpunim të rregullt dhe të hapur me të gjitha OJQ-të e interesuara në vendin tonë. “Në kuadër të zbatimit të ligjit, mirëpres natyrshëm që OJQ-të e vendit të luajnë rolin e tyre të përcaktuar ligjor para publikut, duke qenë të pavarura, objektive dhe të paanshme në misionin e tyre”, tha z.Hajdaraj.

Ndërkaq, Drejtori Ekzekutiv i AVONET-it, z.Kenan Gashi, theksoi se ekzistojnë mundësi të mëdha për të përmirësuar bashkëpunimin e ndërsjellë në kuadër të sigurimit të transparencës publike dhe krijimit të një përfaqësimi më të gjerë për shoqërinë civile.

Takimi i sotëm u përmbyll me pajtimin që të ketë iniciativa më të shpeshta nga të dyja palët për t' i diskutuar çështjet me interes të përbashkët.



Mbahet punëtori për hartimin e draftit të Rregullores për Krijimin dhe Funksonimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit

Prishtinë, 8 nëntor 2024 – Në kuadër të fuqizimit të kapaciteteve të përbashkëta hetimore kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, Këshilli Prokurorial i Kosovës, përkatësisht Grupi punues për hartimin e draftit të Rregullores për Krijimin dhe Funksonimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit, i kryesuar nga Zëvendëskryeprokurori në Prokurorinë Speciale, Valdet Gashi dhe i mbështetur nga Ambasada Britanike në Prishtinë, ka organizuar një punëtori dyditore për hartimin e këtij akti të rëndësishëm nënligjor.



Në punëtori po marrin pjesë përfaqësues të sistemit prokurorial, Policisë së Kosovës, Njësisë së Inteligjencës Financiare, Doganës së Kosovës, Administratës Tatimore të Kosovës edhe përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane dhe Ambasadës Britanike në Kosovë, të Zyrës së BE-së dhe EULEX-it.

Kryesuesi i Grupit punues, Valdet Gashi, tha se qëllimi i hartimit të draftit të Rregullores për Krijimin dhe Funksonimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit rrjedh Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe nga Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit Prokurorial të Kosovës, Policisë së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, përfaqësuar nga Ambasada Britanike në Prishtinë.

Siç u tha më tej nga pjesëmarrësit në sesionet e ditës së parë, rëndësia e këtij dokumenti nënligjor është se me anë të tij do të mundësohet themelimi i ekipeve të përbashkëta hetimore multidisiplinare për të siguruar hetimin dhe ndjekjen më efikase të veprave penale komplekse, të cilat janë në kompetencën e Prokurorisë Speciale të Kosovës.

Gjithashtu, edhe gjatë sesioneve në ditës së dytë vijim do të diskutohen çështjet e përcaktimit të kriterëve, organizimit të brendshëm, metodave operacionale, bashkëpunimit dhe procedurave të punës për Ekipet e Përbashkëta të Hetimit, duke pasur gjithnjë në fokus kryesor përmirësimin e cilësisë së hetimeve në PSRK-së dhe efektivitetin operacional të mekanizmave të tjerë të sigurisë.



Kryesuesi Hajdaraj merr pjesë në prezantimin e Raportit monitorues të EULEX-it për sistemin e drejtësisë

Prishtinë, 11 nëntor 2024 –Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj, mori pjesë në prezantimin e Raportit monitorues të EULEX-it për sistemin e drejtësisë në Kosovë, me anë të të cilit përveç vlerësimit dolën edhe rekomandimet konkrete, të cilat kanë për qëllim fuqizimin e sundimit të ligjit dhe përputhshmërinë me të drejtat e njeriut.



Më këtë rast, në fjalën e tij, Kryesuesi Ardian Hajdaraj, nënvizoi se Këshilli Prokurorial i Kosovës do të marrë për bazë çdo rekomandim që derivon nga ky raport. “Ne e vlerësojmë jashtëzakonisht shumë këtë raport dhe në kohë sa më të shkurtër do t’i ndërmarrim masat e nevojshme për zgjidhjen ose minimizimin e problemeve të evidentuara në të gjeturat e këtij raporti që kanë të bëjnë me sistemin prokurorial”, tha z.Hajdaraj.

Në prezantimin e sotëm të Raportit të EULEX-it për drejtësinë morën pjesë krerët e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare të drejtësisë, ndërsa shefi i Misionit të EULEX-it, Giovanni Pietro Barbano, falënderoi përfaqësuesit e institucioneve të vendit që bashkëpunuan në mënyrë sistematike për hartimin e këtij raporti.



Kryesuesi Hajdaraj priti në takim menaxheren teknike të Projektit të MSI-së, znj. Clare Bambrick

Prishtinë, 12 nëntor 2024 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, së bashku me Drejtorin e Sekretariatit të KPK-së, z. Sami Istrefi, priti në takim Menaxheren teknike të Projektit të MSI-së, znj. Clare Bambrick, me bashkëpunëtorë.



Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për realizimin e projekteve të përbashkëta dhe intensifikimi e aktiviteteve për mbështetjen e planeve të KPK-së, me qëllim të rritjes së kapaciteteve për fuqizimin e zbatimit të ligjit në Kosovë.

Me këtë rast, Kryesuesi Hajdaraj, theksoi se KPK-ja do të vazhdojë partneritetin me MSI-në në kuadër të projekteve që rrjedhin nga programet përkatëse dhe mirëpresin mbështetjen e përpjekjeve tona për të siguruar sundimin e ligjit në vendin tonë. “Nevojat tona janë të fokusuara në fushën e ngritjes së kapaciteteve profesionale, ngaqë sistemi prokurorial përbëhet nga prokurorë të rinj, andaj janë të mirëpritura trajnimet specifike, sidomos ato që ndërlidhen me temat e luftimit efikas të korrupsionit, shpëlarjes së parasë, krimeve kibernetike dhe krimin të organizuar”, theksoi z. Hajdaraj.

Nga ana tjetër, znj. Bambrick, nënvizoi se MSI-ja do të angazhohet konkretisht për të mbështetur dhe mbikëqyrë projektet e përbashkëta që ndikojnë për të përballuar sfidat e hapura dhe për t’i adresuar ato në kuadër të sundimit efikas dhe efektiv të ligjit dhe për të forcuar transparencën, llogaridhënien dhe integritetin e sistemit prokurorial.



KPK dhe ZKPSH reagojnë ndaj komenteve nxitëse, tendencioze, propaganduese dhe linçuese të Zëvendësministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu

Prishtinë, 12 nëntor 2024 - Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, reagojnë ashpër ndaj komenteve të Zëvendësministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu, të bëra në Facebook, duke e quajtur Prokurorinë Speciale “organizatë kriminale”, duke potencuar se deklarimet e tilla krijojnë pasiguri për prokurorët dhe familjet e tyre, sepse kanë përmbajtje jashtëzakonisht nxitëse, tendencioze, propaganduese dhe linçuese ndaj kësaj prokurorie dhe prokurorëve të saj.

KPK dhe ZKPSH, deklarojnë se në vend që Zëvendësministri Sallahu të angazhohet dhe të ketë përkushtim maksimal, vullnet dhe iniciativa të shtuara për ngritjen e kapaciteteve, përmes rritjes së buxhetit të sistemit prokurorial për vitin 2025, i njëjti vihet në ballë të sulmeve sistematike ndaj prokurorive, prokurorëve dhe tërë sistemin prokurorial, duke harruar detyrën dhe përgjegjësitë e tij për t’u marrë me çështjet e avancimit dhe të fuqizimit të kapaciteteve përmes ndarjes buxhetore, që do t’i plotësonin nevojat e domosdoshme për kryerjen e punëve, mungesa e të cilit krijon barriera dhe paraqet vështirësi të mëdha në realizimin e përgjegjësiave institucionale.

Këto dy institucione të pavarura, deklarojnë se nuk do të ndalen asnjëherë para linçimit publik të eksponentëve të tillë politikë, të cilët kanë vënë në shënjestër Prokurorinë Speciale dhe janë vënë në ofensivë denigruese ndaj vlerave të përgjithshme të sistemit prokurorial, duke ndërhyrë paturpësisht në punën e pavarur të Prokurorit të Shtetit, e cila pashmangshëm bie në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.



Gjithashtu nënvizojmë se puna, përgjegjësia, kompetenca dhe misioni i prokurorive dhe i prokurorëve të shtetit nuk janë çështje e vullnetit dhe e fjalomanisë së individëve të caktuar dhe do të mbesin përherë jashtë çdo agjende të politikës ditore dhe nuk do të tolerojmë realizimin e qëllimeve të sojit të z.Sallahu, ngaqë Prokurori i Shtetit përditë e më tepër po intensifikon angazhimet konkrete për ndriçimin e të gjitha rasteve, përfshirë edhe rastet ndaj zyrtarëve të dyshuar që janë në pushtet, duke mos u shmangur assesi nga misioni dhe pavarësia e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.

Mbahet takimi i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 13 nëntor 2024 – Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, diskutoi për vendimin lidhur me autorizimin për të hartuar një analizë ligjore dhe për të nxjerrë rekomandimet që kanë të bëjnë me kërkesën e një anëtarë të KPK-së për rishikimin e shtesës, me ç’rast anëtarët e këtij komisioni janë pajtuar që të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores për Shtesat dhe Kompensimet për të Punësuarit në Sistemin Prokurorial.

Gjithashtu është finalizuar edhe drafti i Rregullores për Vlerësimin e Rezultateve të Punës së Stafit Administrativ dhe drafti i Rregullores për Themelimin e Marrëdhënies së Punës Kontratë për Periudhë të caktuar në sistemin prokurorial, të cilat do të procedohen për miratim në njërin nga takimet e KPK-së.



Mbahet takimi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Prishtinë, 13 nëntor 2024 – Komisioni për Administrim të Prokurorive, i kryesuar nga Jetish Maloku, mbajti takimin e radhës, në të cilin është bërë prezantimi i draftit të Raportit për trajtimin e rasteve me kryerës të panjohur, i cili është trajtuar në një nga takimet e mëparshme të KPK-së, në të cilin është autorizuar prokurori i Prokurorisë Speciale, Admir Shala, për inkorporimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve në raportin në fjalë, si dhe është analizuar numri i nevojshëm i prokurorëve në Prokurorinë Themelore të Gjakovës.





Kryesuesi Hajdaraj priti në takim Menaxherin e Projekti Rajonal të OSBE-së për Monitorimin e Proceseve Gjyqësore, z.Kahramon Sanginov

Prishtinë, 14 nëntor 2024 – Në kuadër të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë që mbështesin sistemin prokurorial, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Ardian Hajdaraj, ka pritur në takim Menaxherin e Projektit Rajonal të OSBE-së për Monitorimin e Proceseve Gjyqësore, z.Kahramon Sanginov, me të cilin diskutoi për raportet monitoruese të OSBE-së dhe përkrahjen që mund të ofrojë kjo organizatë për eliminimin e të gjeturave që dalin nga këto raporte.

Z. Hajdaraj dhe z. Sanginov u pajtuan që të thellojnë bashkëpunimin për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke intensifikuar aktivitetet e përbashkëta për të avancuar kapacitetet për zbatimin e ligjit në Kosovë.



Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizitojnë prokuroritë në Gjakovë dhe në Prizren

Prishtinë, 14 nëntor 2024 - Në kuadër të aktiviteteve të Komisionit Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, kryesuesi i këtij komisioni z. Arian Gashi, së bashku me anëtarët e tjerë, znj. Laura Pula dhe z. Arben Ismajli, vizituan Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe Prokurorinë Themelore në Prizren, ku janë pritur nga Kryeprokurori z. Enis Gashi dhe Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit, z. Petrit Kryeziu.

Gjatë këtij takimi është diskutuar Raporti për lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike për periudhën janar-tetor të vitit 2024, si dhe sfidat e ndryshme në trajtimin e tyre gjatë procesit të punës, me ç'rast anëtarët e Komisionit u informuan në detaje nga Kryeprokurori Gashi dhe U.D. Kryeprokurori Kryeziu për ecurinë e trajtimit të lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike në këto dy prokurori.



Anëtarët e Komisionit dhe dy krerët e këtyre prokurorive u pajtuan që të vazhdojnë trajtimin me prioritet të lëndëve të natyrës së korrupsionit dhe krimeve ekonomike.

Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizitojnë prokuroritë në Ferizaj dhe në Gjilan

Prishtinë, 15 nëntor 2024 – Komisioni Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, i kryesuar nga z. Arian Gashi, së bashku me anëtarin tjetër, z. Arben Ismajli, vizituan Prokurorinë Themelore në Ferizaj dhe Prokurorinë Themelore në Gjilan, ku janë pritur nga kryeprokurorët z. Shukri Jashari dhe z. Arben Kadriu.



Edhe në këtë vizitë është diskutuar lidhur me Raportin për lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike për periudhën janar-tetor të vitit 2024 dhe për sfidat në trajtimin e tyre gjatë procesit të punës.

Anëtarët e këtij Komisioni janë informuar nga kryeprokurorët Jashari dhe Kadriu për trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike në këto dy prokurori dhe njëherësh janë pajtuar të vazhdohet me trajtimin me prioritet të lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike.



Vazhdojnë vizitat në prokurori, në Pejë dhe Mitrovicë diskutohet për trajtimin me prioritet të lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike

Prishtinë, 20 nëntor 2024 –Komisioni Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, i kryesuar nga z. Arian Gashi, së bashku me anëtarën tjetër, znj. Laura Pula, ka vazhduar vizitat nëpër prokuroritë e vendit, me ç’rast sot ishin në Pejë dhe në Mitrovicë, ku u pritën nga U.D. Kryeprokurori z. Ersan Qavolli dhe U.D. Kryeprokurori Nijazi Rexha.



Sikurse edhe në prokuroritë e tjera, edhe në vizitën e sotme në këto dy prokurori është diskutuar Raporti për lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike për periudhën janar-tetor të vitit 2024 dhe sfidat në trajtimin e tyre.

Z. Qavolli dhe z. Rexha informuan anëtarët e Komisionit për ecurinë e trajtimit të lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike në prokuroritë në Pejë dhe në Mitrovicë dhe shprehën pajtimin e përbashkët për vazhdimin e trajtimit me prioritet të lëndëve të natyrës së korrupsionit dhe krimeve ekonomike.



Reagim i KPK-së dhe i ZKPSH-së ndaj deklaratave të Ministrit Murati për Prokurorinë Speciale

Prishtinë, 25 nëntor 2024 - Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit reagojnë ndaj deklaratës së Ministrit të Financave dhe Transfereve, z.Hekuran Murati, të bërë dje për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

Më këtë rast, KPK dhe ZKPSH kërkojnë që bartësit e funksioneve qeveritare të jenë të kujdesshëm, të përmbajtur dhe të mos pengojnë punën e prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale dhe kryerjen e detyrave kushtetuese dhe ligjore.

Puna dhe veprimet e prokurorëve të shtetit, përfshirë këtu Prokurorinë Speciale, janë objektive, profesionale, të bazuara në ligj, prova dhe fakte.

Andaj, tendencat e akterëve të partive politike, përfshirë këtu përfaqësuesit e Qeverisë, të cilët synojnë të minojnë kredibilitetin dhe profesionalizmin e Prokurorisë Speciale, kanë qenë dhe do të jenë të dështuara.

KPK dhe ZKPSH mbështesin Prokurorinë Speciale në ushtrimin e funksioneve të saj, përkatësisht në luftën e pakompromis ndaj të gjitha veprave penale që kjo prokurori i ka në kompetencë.



Mbahet Takimi i 257-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 25 nëntor 2024 – Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 257-të me radhë, kurse vendimet që u morën në takimin e sotëm janë si vijojnë:

1. Miratoi Raportin për periudhën gjashtëmujore (janar–qershor 2024) të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për Veprat Penale Karakteristike;
2. Miratoi Rregulloren për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar në Sistemin Prokurorial;
3. Miratoi Rregulloren për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të Stafit Administrativ të Sistemit Prokurorial;
4. Aprovoi dërgimin e propozimit të Presidentja për lirim nga detyra të Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit, z. Xhevdet Bislimi, me rastin e pensionimit;
5. Konfirmoi listën e kandidatëve që kanë aplikuar për Kryeprokuror të Prokurorisë së Apelit dhe kryeprokurorë të prokurorive themelore në: Ferizaj, Pejë, Mitrovicë, Gjilan dhe Prizren;
6. Miratoi Raportin përfundimtar të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve për vlerësimin e performancës së dymbëdhjetë (12) prokurorëve të Grupit të III-të;
7. Miratoi Raportin përfundimtar të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve për vlerësimin e performancës së dhjetë (10) prokurorëve të Grupit të V-të;



8. Miratoi Raportin përfundimtar të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve për vlerësimin e performancës të nëntë (9) prokurorëve të Grupit të VI-të;
9. Miratoi Raportin e Panelit Hetimor për shkeljet disiplinore të një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prizren, ndërsa vendimi i KPK-së do të publikohet në përputhje me ligjin në fuqi;
10. Aprovoi kërkesën e partnerëve ndërkombëtarë për qasje në dokumentet e kandidatëve në procesin e përzgjedhjes së kryeprokurorëve, me mundësinë e shikimit të plotë dhe jo kopjimit apo posedimit të këtyre dokumenteve;
11. Autorizoi Komisionin për Çështje Normative për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Shtesat dhe Kompensimet për të Punësuarit në Sistemin Prokurorial;
12. Autorizoi Komisionin për Çështje Normative për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës së Këshillit Prokurorial të Kosovës.



Komisioni Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike viziton Prokurorinë Themelore në Prishtinë

Prishtinë, 26 nëntor 2024 –Komisioni Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, i kryesuar nga z. Arian Gashi, së bashku me anëtarin z. Arben Ismajli, vizituan sot Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ku u pritën nga Kryeprokurori z. Zejnullah Gashi dhe Zëvendësja e Kryeprokurorit, znj. Elsa Bajrami – Kastrati. Në këtë takim morën pjesë edhe prokurorët e Njësitit për Krime Ekonomike dhe Korrupsion dhe Udhëheqësi i Departamentit për Krime të Rënda të kësaj prokurorie, z. Bashkim Zeqa.

Më këtë rast u diskutua për Raportin e lëndëve të korrupsionit dhe të krimeve ekonomike për periudhën janar-tetor të vitit 2024 dhe, rrjedhimisht, z. Gashi dhe z. Ismajli janë njohur nga afër me sfidat e kësaj prokurorie që kanë të bëjnë me trajtimin e këtyre lëndëve penale.



Kryeprokurori Gashi informoi bashkëbiseduesit për angazhimin e shtuar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë për trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, kurse kryesuesi i Komisionit Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, z. Arian Gashi, nënvizoi se do të ketë angazhim të përbashkët për trajtimin me prioritet të këtyre rasteve.

Mbahet Takimi i 258-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 29 nëntor 2024 – Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 258-të me radhë, në të cilin mori vendim për:

1. Themelimin e Panelit Hetimor për rastin disiplinor AD me nr. 6/2024 ndaj një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prizren.

